

**PERMBLEDHJE JO TEKNIKE
E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS**

**EMERTIMI I AKTIVITETIT:
KAPANON INDUSTRIAL PER PERPUNIMIN E DRURIT**

**VENDODHJA:
PRANE AUTOSTRADES TIRANE-DURRES, NE RRUGEN INDUSTRIALE, NE
AFERSI ME ZONEN E MEGATEKUT**

Sipas shtojces 1 te ligjit Nr.10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisi", i ndryshur:
Veprimtarite e lendes se drurit, pika 7.10. Prodhim i produkteve te perbera teresisht apo
kryesisht nga druri. Te gjitha instalimet leje e tipit B.

Kerkues:
Subjekti: "Inova Wood 23"
NIPT : M31325023F

Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis u hartu nga studio:
"Gjeokonsult & Co" Sh.p.k

Perfaqesuesi i shoqerise:

Xhevahir Mustafa



Eksperti i mjedisit:

Dr. Ferdinand Kurteshi

Tirane, 2025

1. PERSHKRIM

- Objekti “**Kapanon Industrial per Perpunimin e Drurit**” eshte i ndertuar dhe nuk do kete punime ne zonen ku do zhvillohet projekti dhe ne terrenin perreth.
- Ka si qellim perpunimin e drurit dhe pershtatja e tij ne krijimin e elementeve te mobilimit, interiere ose eksteriere.
- Nderhyrja e vetme qe objekti do kete eshte pershtatja per perpunimin e drurit qe do behet me nje impakt minimal dhe pa ndikime ne mjedisin perreth ne terma afatshkurte dhe afatgjate.
- Objekti ndodhet ne zonen industriale mes autostrades Tirane-Durres ne rrugen Industriale ne afersi me zonen e Megatekut dhe sherben per prodhimin dhe magazinimin e mobiljeve prej druri.
- *I gjithe territori eshte i rrethuar, i ndricuar dhe i siguruar me roje gjate gjithe kohes. Mjediset e brendeshme dhe territori rreth objektit jane te kontrolluara ne cdo kohe me kamera vezhgimi.*
- *Objekti eshte ndertuar ne km.8 te Rruges dytesore Tirane Durres*
- *Objekti perbehet nga: dy kate, Kati perdhe ne kuoten 0.00 me Sip=1617 m²*
- *Kati I I-re qe sherben per zyra administrative me Sip=200 m²*
- Midis godines dhe rrethimit te objektit do te kete hapsira te sistemuara dhe me dimensione te konsiderueshme per afrimin dhe manovrimin e automjeteve te kapaciteteve te ndryshme.



Ortofoto e vendodhjes se aktivitetit



Planvendosje e magazines

Objekti ndodhet ne rrugen Industriale, ne zonen industriale, ne bashkine Tirane. Ndodhet ne nje zone me ndertesa industriale te tipit magazina, Show room, dhe zyra sherbimi. Objekti ndodhet ne nje zone qe ka pesuar ndryshime te shumta ne vitet e fundit me ndertime dhe urbanizim te shpejt. Aktualisht ne zonen ne afersi te objektit po rindertohej linja hekurudhore Tirane-Durres.



Objekti ndodhet i pozicionuar sipas koordinatave GAUSS KRUGER (Bazuar ne harten topografike me nomenklatur K-34-88-C-d (Vora):

	E	N
Pika 1	474598	4581700
Pika 2	474559	4581708
Pika 3	474534	4581610
Pika 4	474573	4581604

Foto ilustruese e proceseve te punes



Pamje te makinerive te nevojshme per proceset e punes



Trapan statik



Ujevare per lyerjen



Prese automatike me bord 4 faqe per prodhim dyersh dhe tavolinash, procesi zgjat rreth 7 min



Sharre skajuese me bango 5.5 metra per çarjen e trungjeve te medhenj, procesi zgjajt 1 sharrim per min



Karrel skajues per prodhim kapak guzhine dhe elemente te tjere te drurit



Freze e fingerjoint procesi 1 minut



Sharre per hapjen e gojave per lidhje proçesi 1 minut



Zumpatriçe zmeriluese per zumparim suprine 1 minut nje proçes



Freze per prodhim e lidhjes se sirtarit 1 minut proçesi



Kombinat disk freze per sharrim dhe freze druri 1 minut



Kombinat me 3 proçese shpim plan dhe skajues disku 1 min



Plan grose dhe skajues 4 faqor me 4 proçese



Grose per ngrenie derrase nga siper



Plan per pastrim derrase



Kalibrues 138 CM per zumparim e elementeve te ngjitura ose suprinave



Torno kopjuese megaton per prodhim elemente ne seri me bord te automatizuar



Sharre shirit per prerje çarje derrasash dhe forma



Pantograf rover A per forma te ndryshme me kompjuter



Kompresor ajri gx5



Zmerilues per suprina



Radial 100 per prerje elementesh 100 cm



Pirun H30

Pamje te ambjenteve te punes



2. Informacion per qellimin e vnm dhe metodiken e zbatuar

Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor per VNM dhe ka per qellim qe te parashikoj, indentifikoj, te vleresoj dhe parandaloj ose minimizoj ndikimin ne mjedis te projektit te propozuar.

Procedura e vleresimit te ndikimit ne mjedis perfshin:

- Procesin paraprak te vleresimit te ndikimit ne mjedis
- Procesin e thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis.

Dokumenti baze ku mbeshtetet procesi i VNM-se, eshte raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis, i cili, ne varesi te ndikimeve te mundeshme te projektit mund te jete:

- Raporti paraprak i VNM-se per projektet e shtojces II te ligjit Nr.10440, date 07.07.2011.
- Raport i thelluar i VNM-se per projektet e shtojces I te ligjit Nr.10440, date 07.07.2011.

Objektivat afatshkurter te VNM jane:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore te projektit te propozuar,
- Indentifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundeshme potenciale te projektit te propozuar,
- Siguron qe eshte perzgjedhur alternativa me e mire e vendndodhjes se projektit,
- Siguron qe jane marre ne konsiderat teknikat me te mira te disponueshme te keknologjis se propozuar per tu aplikuar,
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence,
- Mundeson informimin e vendimmarresve, duke gjykuar ne miratimin ose jo te projektit dhe kushteve qe duhet te vendosen ne aktin e miratimit.

Objektivat afategjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut,
- Ndikon ne mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve,
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimet e pakthyeshme te mjedisit,
- Permireson aspektet sociale – ekonomike te projektit,
- Ndhmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshen te mjedisit.

Pershkrim i permbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional qe lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimet e komponenteve te vecante dhe te rendesishem te mjedisit nga faktore te ndryshem, njerezor dhe natyror.

Nder ligjet me kryesore ne lidhej me kete projekt, mund te permendim:

- Ligj nr.10431 date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”,
- Ligji nr.10440 date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” si dhe Ligjin Nr 12, date 26.02.2015 “Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10440 date 7.7.2011”.
- Ligji nr.10448 date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”.

- Ligji nr.8897, date 16.5.2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja", amenduar me ligjin Nr.10 266, date 15.4.2010 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.8897, date 16.5.2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligji Nr. 111/2012" Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore",
- Ligji Nr.9774, date 12.7.2007 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis",
- Ligji Nr. 9587, date 20.7.2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit ", amenduar me Ligjin Nr. 37\2013 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006 "per Mbrojtjen e biodiversitetit" dhe ligjin Nr. 68/2014" Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, "Per mbrojtjen e biodiversitetit",
- Ligj Nr. 10463, date 22.09.2011, "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve",
- Vendimi nr.123, date 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave",
- Ligji nr.9108, date 17.07.2003 "Per substancat dhe preparatet kimike",
- VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (vnm) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore".
- VKM Nr.575, date 24.06.2015, "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte".
- VKM Nr. 247, date 30.4.2014 "Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore".
- VKM Nr. 177, date 31.03.2005 " Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjedisve ujore pritese,
- VKM Nr.435, date 12.09.2002 "Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer".
- VKM Nr. 103, date 31.03.2002 "Per Monitorimin Mjedisor ne Republiken e Shqiperise:"
- VKM Nr. 419, date 25.06.1014 "Per miratimin e kerkesave te posatqme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipeve A, B dhe C, per trasferimin e lejeve nga nje subjekt tek tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullat e hollesishme per shqyretimin e tyre nga auoritetet komponente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL",
- Vendimi nr. 417, date 25.6.2014 "Per miratimin r tarifave te lejeve te mjedisit",
- Udhezim Nr.8 date 27.11.2007, i Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave dhe Ministrise se Shendetesise "Mbi nivelet kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara"
- Rregullore Nr.1 date 15.03.2006 "Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet e ne mjedis te veprimtarive ndertimore"

Bazuar ne Ligjin nr.10448 date 25.6.2014 "Per lejet e mjedisit", ky aktivitet, perfshihet ne listat e aktiviteteve te cilat duhet te paisen ne leje mjedisore te tipit A, B ose C. (Konkretisht veprimtarit e lendes se drurit, Pika 7.10, Prodhim i produkteve te perbera teresisht apo kryesisht nga druri.)

Te gjitha instalimet leje e tipit B.

3. Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes se zones perreth

Aktiviteti ne vleresim zhvillohet ne nje objekt tip magazine i cili eshte i ndertuar tashme me infrastrukturen e nevojshme te ngritur. Ambienti i brendeshm i rrethimit te objektit nuk ka hapsira te medha keshtu qe edhe bimesia eshte e reduktuar.



Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit

Nder tipet kryesore te habitateve ne zone permendim:

- a) Pyjet dhe shkorreta mesdhetare ne brigjet e lumit te Tiranes (formacionet e makjes)
- b) Toka bujqesore

Brigjet e lumit te Tiranes shpesh me shtrat te gjere jane te mbuluar me vegetacion hidro-higrofil.

Shoqerimet bimore kryesore te pyjeve aluvionale u perkasin klasave Alno-Populetea dhe Salicetea purpurea.

Perberesit kryesore te pyjeve aluvionale te zallishteve te lumit te Tiranes jane: Platanus orientalis, Alnus incana, Populus alba, Salix alba, Salix purpurea, Salix amplexicaulis, etj.

Ne ujerat me rrjedhje te shpejte marrin prioritet shoqerimet me Platanus orientalis apo te ashtuquajtura rrapishte. Krahas ketyre formacioneve te dominuara nga rrap (Platanus orientalis) vihen re edhe formacione te dominuara nga Populus alba.

Ne katin shkurre te ketyre pyjeve verehen llojet bimore: *Salix elaeagnos*, *Tamarix parviflora*, *Rubus ulmifolius*, *Crataegus monogyna*, *Rosa sempervirens*, *Vitex agnus castus* etj.

Gjithashtu ne keto rrjedha jane te pranishme shoqerimet bimore te klases *Phragmitetalia* me asociacionin kryesor *Phragmites australis* si dhe shoqerimet bimore te shavarit (*Typha angustifolia*). Nje asociacion i tille tregon nje plasticitet te larte ekologjik.

Brezi i pyjeve dhe shkorretave mesdhetare perfaqeson formacionin baze dhe me perhapjen me te madhe. Shoqerimi i *Quercetum cocciferii* formon formacionin shkurre te dominuar nga pralli. Shoqerimi i *Arbuto-Ericetum*, i marese me shqopen, eshte formacioni bimor me i perhapur ne kete lugine.

Formacione te pyjeve te *Quercus frainetto* e *Quercus cerris* si dhe stadeve te degradimit te tyre (*Carpinus orientalis*, *Ostrya carpinifolia*) takohen ne nje pjese te konsiderueshme, deri ne 1200 m lartesi mbi nivelin e detit, por rrallëherë në gjendje të mirë. Nga pikpamja fitosociologjike këto pyje i përkasin rendit *Quercetalia pubescentis* dhe aleancës *Quercion frainetto-cerris*, *Ostryo-Carpinion orientalis*. Pylli natyror dominohet kryesisht nga *Quercus cerris*, i shoqeruar nga *Quercus pubescens* apo *Quercus frainetto*.


Edhe flora barishtore paraqitet e pasur ne kete zone. Nder llojet me te pranishme te zones permendim: *Origanum vulgare*, *Psoralea bituminosa*, *Trifolium campestre*, *Dorycnium pentaphyllum*, *Brachypodium ramosum*, *Campanula glomerata*, *Dictamnus albus*, *Micromeria Juliana*, *Micromeria graeca*, *Bellis perennis*, *Dactylis glomerata* etj.

Ka nje prani te tokave bujqesore ne veri te zones ku ndodhet objekti. Kemi te bejme me toka bujqesore te punuara dhe me bonitet te larte.

Ne Shqiperi zonat e mbrojtura sidomos 10 vjecarin e fundit, jane kthyer ne nje objekt te rendesishem pune te disa institucioneve te vendit, te cilat kane synuar ne evidentimin, ruajtjen, miremenaxhimin e perdorimin ne menyre te qendrueshme te tyre. Aktualisht ne shqiperi zonat e mbrojtura perbejne rreth 10% te territorit. Rajoni ne fjale nuk bene pjese ne zonat e mbrojtura.

4. Informacion per pranin e burimeve ujore ne zonen e zhvillimit te aktivitetit dhe ne afersi te tij

Ne zonen e zhvillimit te ketij aktiviteti nuk ka burime ujore te identifikuara. Konkretisht siperfaqet ujore me te aferta me objektin ne vije ajrore jane Liqeni i Gjokes 1.80 km larg, rezervuari i Kasharit 2.6 km larg, nga deget e lumit te Tiranes 1.40 m, dhe 0.46km larg.



5. Identifikimi i ndikimeve te mundeshme negative ne mjedis

Lloji i ndikimeve te identifikuara

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

Parimi i zhvillimit te qendrueshem

Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake

Parimi i ruajtjes se burimeve natyrore

Parimi i zvendesimit dhe kompesimit

Parimi i qasjes se integruar

Parimi i pergjegjesise se ndersjelle dhe bashkepunimit

Parimi ndotesi paguan

Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut

Parimi i nxitjes se veprimtarise per mbrojtjen e mjedisit.

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit nr.10440 date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" dhe VKM nr.686, date 29.07.2015 "Per miratimin e rregullave, te pergjegjsive dhe afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore" ka si synim identifikimin, vleresimin, dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e demtimi. Kjo perben perparesi kombetare dhe eshte e detyrueshme per cdo banor te republikes se shqiperise, per te gjitha organet shteterore,

si dhe per personat fizik dhe juridik, vendas e te huaj, qe ushtrojne veprimtarine tyre ne territorin e Shqiperise.

Objektivat e mbrojtjes se mjedisit jane:

- Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes se ujit, ajrit, tokes dhe ndotjeve te tjera
- Ruajtja, mbrojtja dhe permiresimi i natyres dhe i biodiversitetit
- Ruajtja mbrojtja dhe permiresimi i qendrushmerise mjedisore me pjesemarrje publike
- Perdorimi i matur dhe racional i natyres dhe i burimeve te saj
- Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike te peisazhit natyror
- Mbrojtja dhe permiresimi i kushteve te mjedisit
- Mbrojtja dhe permiresimi i cilesise se jetes dhe shendetit te njeriut.

6. Ndikime te rendesishme gjate zhvillimit te aktivitetit

Emetimet ne ajer

Shkarkimet ne ajer vijne nga proceset e punes. Duke qene se ne ambjentet e brendeshme gjate procesit te perpunimit te drurit, siç jane prerja, gdhendja, lustrimi, dhe furrat e ngrohjes, krijohet pluhur i cili mund te perbeje rrezik per shendetin e punonjesve, duke shkaktuar probleme me frymemarrjen, alergji, etj., eshte e detyrueshme te perdoren sistemet e ventilimit, i cili ndihmon ne mbajtjen e nivelit te pluhurit te ulet dhe parandalimin e ndotjes ajror. Kjo mund te arrihet permes sistemeve te grumbullimit te pluhurit (p.sh., me ndihmen e filtrave dhe aspiratoreve) qe jane te lidhura me makinat qe prodhojne pluhur.

Keto sisteme gjithashtu mund te perfshijne filtra per te pastruar ajrin nga substanca te tjera te demshme, si p.sh. kimikate qe mund te perdoren gjate procesit te perpunimit te drurit (per shembull, ngjyrat, perberesit e llakeve, etj.).

Vibrimet dhe zhurmat

Shkarkimet e zhurmave mund te krijohen nga shume operacione gjate aktivitetit te magazines dhe varen nga shume faktore si p.sh.

- perdorimi i makinave si frezatori, thika elektrike dhe makinat e perpunimit te drurit,
- transporti i materialeve gjithashtu kontribuojn ne nivelin e zhurmes, sidomos kur perdoren kamione ose karroca,
- perdorimi i mjeteve manuale, si skelat ose çekiqet.

Per te minimizuar ndikimet negative te zhurmes, eshte e rendesishme te implementohen masa si izolimi akustik, perdorimi i mjeteve me pak zhurmshem dhe trajnimi i punonjesve per te perdorur teknike te sigurt.

Ndikimi ne toke

Keto procese pune nuk kan ndikim me toke.

Ndikimi ne biodiversitet

Ky aktivitet nuk ka ndikim ne biodiversitet.

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet e ngurta te krijuara nga perpunimi i drurit (si tallashet) jane mbetje te riciklueshme, pasi perdoren si lende djegese ne furrat me dru, dhe materiale te tjera si metalet, plastika, tekstilet do te magazinohen perkohesisht brenda ambjenteve te objektit si dhe do te diferencohen ne te njejten kohe, sipas materialit. Ne vijim do te lidhet kontrate me Subjekte te Licensuara per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve. Transporti do te behet me automjete te pershtatshme ne pronesi te ketyre subjekteve, duke mbajtur ne konsiderate respektimin e pastertise se ambientit.


Distanca nga zonat e banuara

Qyteti i Tiranes eshte zemra ekonomike e Shqiperise, me perqendrimin e numrit me te madh te bizneseve ne shkalle vendi si dhe me zhvillimin e industrise se lehte. Fuqia ekonomike e Tiranes dallohet te sasia shume me e larte e kursimeve dhe e kreditit ne rang kombetar, te te ardhurat tatimore, te cilat ne mase dermuese realizohen ne Tirane si dhe te zhvillimi i sektorit te ndertimit.



Foto te objektit

Bazuar ne karakteristikat dhe elementet e projektit, distanca e ndikimit ne mjedis mund te shtrihet vetem ne nje zone periferike te kufizuar dhe ku nuk mund te ndikohen ne objekte banime. Theksojm se objekti ndodhet ne zonen industriale mes autostrades Tirane-Durres ne nje zone me ndertesa industriale, pothuajse ne te njejta funksione, te tipit magazina, si Show room, dhe zyra sherbimi. Ky objekt ndodhet i pozicionuar rreth 400 m deri ne 1km distance nga qendrat e banuara.



7. Informacion per kohezgjatjen e mundeshme te ndikimeve negative

Ndikimet ne mjedis zgjasin per aq sa zgjat procesi i punes ne dite dhe aktiviteti gjate nje viti.

8. Shtrirja hapsinore e ndikimit negativ ne mjedisin e zones

Ne kushte normale te zhvillimit te aktivitetit, nuk vleresohen ndikime te rendesishme te cilat mund te shkaktojne ndotje, per rajonin nuk perben problem. Problemi i vetem qe mund te shkaktohet eshte cilesia e ajrit ne ambjentete punes i cili mund te rregullohet duke perdorur sistemet e ventilimit, i cili ndihmon ne mbajtjen e nivelit te pluhurit te ulet dhe parandalimin e ndotjes se ajrit.

9. Rehabilitimi i mjedisit te ndikuar dhe mundesia e kthimit te tij ne gjendjen e mepareshme.

Duke qene se objekti eshte ekzistues, nuk ka punime te tjera shtese, nuk ka punime toke, demtim bimesie, pra nuk ka nevoj per rehabilitim te mjedisit. Per shkarkimet ne ajer zgjidhje eshte krijimi i sistemeve te filtrimit.

10. Masat e mundeshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe do te zbatohen nga kontratuesit per zbatimin e projektit. Ndikimet negative ne mjedis gjate shfrytezimit te objektit jane ne nivele te ulta. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte shenuar.

- Te menaxhohen ne menyre te sigurt nese ka mbetje me perberje te elementeve te rrezikshem si asbesti ne bashkepunim me institucionet perkatese.
- Sistemi i shkarkimit te ujerave urbane te jete i lidhur me sistemin e kanalizimeve te Zones.
- Te zbatohen kushte te mira pune dhe higjene per punonjesit.
- Te behet monitorim i vazhdueshem i cilesis se ajerit ne ambjentet e punes.
- Implementohen masa si izolimi akustik, perdorimi i mjeteve me pak zhurmshem dhe trajnimi i punonjesve per te perdorur teknike te sigurt.
- Te aplikohen praktika te qendrueshme, si perdorimi i teknologjive te pastra dhe menaxhimi efikas i mbetjeve.
- Perdorimi i materialeve termoizoluese ne ambjentet e magazinimit.
- Te zbatohen kushte te larta sigurie dhe te jene ne gadishmeri pajisjet e mbrojtjes nga zjarri.

11. Ndikime te mundeshme ne mjedisin nderkombetar

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoj edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar.